

TÜV®

TÜV NORD CERT –

Standarti ISO 45001:2018

Sistemi I Manaxhimit te Sigurise dhe Shendetit ne Pune- Pikeveshtrim Sistematik



ISO 45001:2018 HSMS-OHSAS



Organizata Nderkombetare e Punes (ILO) deklaroi se çdo vit, me shume se 2.5 milione njerez ne bote, humbasin jeten per shkak te aksidenteve ne vendin e punes. Me gjithë statistikën në lidhje me numrin e aksidenteve me fatalitet në punë, Ligjet, Rregulloret e aplikuar dhe Standartet e Manaxhimit të Shendetit dhe Sigurisë në Punë po krijojnë një kuader në përmirësim, ndërgjegjësim dhe kanë zvogëluar aksidentet fatale të punonjësve.

Standardi i ri ISO 45001:2018 u publikua më 12 Mars 2018 dhe aplikohet në të gjithë botën. Ai zëvendëson BS OHSAS 18001:2007

Ai synon të arrijë përmirësimin e vazhdueshëm të profesionalizimit të trajtimit të shendetit dhe sigurisë në punë.

Avantazhet e certifikimit

Në shumë sfera, sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë japin një kontribut serioz në parandalimin dhe reduktimin e shendetit. Sot ato tashmë janë marrë si të mirëqena nga shumica e organizatave .

Kalimi në ISO 45001:2018 kërkon kohë shtesë dhe përpjekje. Por angazhimi ia vlen. Certifikimi ka një ndikim pozitiv kur bëhet fjalë për zhvillimin e kompanisë e cila duhet të përfitojë nga kjo mundësi që e bën kompaninë më të qëndrueshme dhe fitimprurëse nga pikepamja financiare.

Struktura e Nivelit të Lartë të këtij standardi, gjithashtu, bën të mundur kombinimin e ndryshëm të aspekteve si cilësia, mjedisi dhe menaxhimi i energjisë

Ku Standardi, për çka përfaqëson, rrit nivelet e bashkëpunimit me punonjësit.

Struktura e ISO 45001:2018 përben

- strukture identike për të gjitha sistemet e menaxhimit
- përdorimi i njëjtit tekst dhe termave baze
- standard me të lehtë për t'u kuptuar
- zbatimin më efikas të integruar me sistemet e menaxhimit

TÜV®

Dhjetë pikat kryesore të ISO 45001:2018:

- 1 Qellimi/Fusha e aplikimit
- 2 Referenza
- 3 Terma dhe perkufizime
- 4 Konteksti i Kompanise
- 5 Leadership dhe pjesemarrja e punonjesve
- 6 Planifikimi
- 7 Mbeshtetja
- 8 Veprimtaria
- 9 Vleresimi i performances
- 10 Permiresimi

Cfare duhet te konsiderojme ne lidhje me rreziqet dhe mundesite ne kontekstin e ISO 45001?

ISO 45001 ndjek mentalitetin e bazuar ne vleresimin e rrezikut.

Kjo do te thote qe organizatat duhet te marrin parasysh rreziqet dhe mundesite e tyre me me kujdes se me pare dhe t'i identifikojne ato ne perputhje me rrethanat. Ne vend qe te reagojne ndaj pasojave qe kane ndodhur tashme, organizatat duhet te bejne plane specifike paraprake se si duhet te trajtohen efektet e mundshme. Vleresimi i rreziqeve dhe mundesive dhe veprimet korigjuese dhe parandaluese, mund te lidhet, per shembull, me investime (makineri te reja), infrastrukture te brendshme, inovacione apo monitorim i vazhdueshem furnitoresh.

Rep. TÜV NORD in Albania

Elvis Pazaj

Rruga Bardhyl 16

1005, Tirana, Albania

epazaj@tuv-nord.com

+355 6920 31015

+355 445 31015

Pjesemarrja dhe konsultimi

Kompania duhet te sigurohet qe te kete krijuar kushtet per pjesemarrje dhe konsultim te punonjesve dhe perfaqesuesit e tyre, nese ka, ne lidhje me vendimet qe i perket sistemit te menaxhimit te OH&S.

Kompanite do te duhet, gjithashtu, te aplikojne nje proces per identifikimi i mundesive per permiresimin e kualifikimit te personave pergjegjes per shendetin dhe sigurine.

Mundesi te tilla lindin nga:

- ndryshimet organizative
- vendime per eliminimin e rreziqeve per shendetin dhe sigurine ne vendin e punes
- pershtatja e kushteve te punes me nevojat e punonjesit

Procesi i Auditimit

Brenda procesit te auditimit, eshte shume e rëndesishme te sigurohet qe pjesemarrjesit sipas kerkesave te paragrafeve te standartit dhe rregullat e akreditimit te merren parasysh. Ne ISO 45001, Pjesemarrjesit duhet te percaktohen qartesisht me rrolet e tyre specifike:

- Manageri i personelit me pergjegjesine ligjore per Shendetin dhe sigurine ne pune,
- Personeli i menaxhimit qe merret me personelin me kohe te perhershme dhe te perkoheshme
- Perfaqesuesi i punetoreve me pergjegjesine per Sigurine dhe Shendetin ne Pune
- Personeli qe monitoron shendetin e punonjesve
- Ne procesin e auditit, Menaxhmenti dhe Punonjesit duhet te intervistohen ne vendin e punes-vendin e auditimit.